



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
Drejtoria e Prokurimeve

Nr. _____ Prot

Korçë më, 06.07.2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Date 06.07.2022

Drejtuar: **SHOQERIA “KORSEL ”SHPK**, adresa : *Korçë, Lagjja 17, Rruga Midhi Kostani, Prane Hipotekes, Objekti Nr. 23.*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-31573-06-02-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **Mirëmbajtja e varrezave publike dhe të dëshmorëve**

Afati: **12 muaj**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 06.06.2022, Nr.72**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqeria “ Ina ”shpk, NIPT J61814009W me vleren:

2,714,955.45 (dy milion e shtateqind e katermbedhjete mije e nenteqind e pesedhjete e pese, pike dyzet e pese) lekë pa tvsh.

2. Shoqeria “ Korsel ”shpk, NIPT J64104124G me vleren:

3,708,012 .8 (tre milion e shtateqind e tete mije e dymbedhjete, pike tete) lekë pa tvsh.

Nga pjesërmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqëria Ina shpk per arsye se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, mbas verifikimit të ofertave të paraqitura, beri llogaritjet për të parë nëse ka oferta anomalisht të ulëta duke aplikuar formulën e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik nën 82 pika 4 “ Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;”

Mbas llogaritjeve të bëra u konstatua se oferta e paraqitur nga shoqëria “Ina” sh.p.k ishte me cmim anomalisht të ulët, në këto kushte bazuar në **93 pika 1 dhe 2 e Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”**, me shkresën Nr 5517 date 17.06.2022 KVO ka kërkuar shpjegime për justifikimin e cmimeve të propozuara në oferte .

Shoqëria “Ina” sh.p.k nuk ka dorëzuar asnjë sqarim apo argumentim lidhur me ofertën e paraqitur prej saj.

Duke qënë se ofertuesi nuk ka dorëzuar sqarime lidhur me ofertën e paraqitur prej tij, bazuar në nenin 93 të LPP dhe VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nën 82 pika 4 ku përcaktohet shprehimisht se : “Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së. “, oferta e paraqitur prej tij refuzohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqërinë “Korsel” shpk me adresë: Korçë, Lagjja 17, Rruga Midhi Kostani, Prane Hipotekes, Objekti Nr. 23**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,708,012 .8 (tre milion e shtatëqind e tete mije e dymbëdhjetë, pike tete) lekë pa tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**